	<p>Këshilli Ndërkombëtar për Rrjetet e Mëdha Elektrike Komiteti Nacional CIGRE Kosovë RREGULLORE E MIRËNJOHJEVE <i>ver. 1.0</i></p>	<p>KN CIGRE KO <i>page 1 / 5</i></p>
---	--	---

Në bazë të Nenit 10 dhe Nenit 18 të Statutit të Komitetit Nacional CIGRE Kosovë, Bordi Teknik Nacional i KN CIGRE KO në takimin e mbajtur me datë 26.03.2018 ka miratuar:

RREGULLOREN E MIRËNJOHJEVE

Dispozitat e Përgjithshme

Neni 1

Komiteti Nacional CIGRE Kosovë (që njihet si “KN CIGRE KO”) krijon këto mirënjuhje:

- Mirënjuhje për Përvojë Jetësore;
- Falënderim për Punë Aktive në Komitete Studiuese;
- Mirënjuhje për Punimin Më të Mirë;
- Pllakatë nga Bordi Teknik Nacional;

Certifikatat e mirënjuhjeve do të lëshohen për secilin çmim sipas listës së mësipërme.

Neni 2

Certifikata “Mirënjuhje për Përvojë Jetësore” duhet të përmbajë tekstin si në vijim:

Komiteti Nacional CIGRE Kosovë ndanë këtë:

MIRËNJOHJE

Prof. (emri & mbiemri)

për

Përvojë Jetësore

(Certifikata nënshkruhet nga Kryesuesi dhe nga Sekretari i KN CIGRE KO).

Neni 3

Certifikata “Falënderim për Punë Aktive në Komitetin Studiues” duhet të përmbajë tekstin si në vijim:

Komiteti Nacional CIGRE Kosovë ndan këtë:

FALENDERIM


(emri & mbiemri)

për

Punë Aktive në Komitetin Studiues **(KS XY)**

(emërtimi i Komitetit Studiues)

(Certifikata nënshkruhet nga Kryesuesi dhe nga Sekretari i KN CIGRE KO).

	<p style="text-align: center;">Këshilli Ndërkombëtar për Rrjetet e Mëdha Elektrike Komiteti Nacional CIGRE Kosovë</p> <p style="text-align: center;">RREGULLORE E MIRËNJOHJEVE</p>	<p style="text-align: center;">KN CIGRE KO</p>
	<i>ver. 1.0</i>	<i>page 2 / 5</i>

Neni 4

Certifikata “Mirënjohje për Punimin Më të Mirë” jepet duke u bazuar në Rregulloren e Punës së Konferencave të KN CIGRE KO, Neni 29 – Neni 35.

Neni 5

Certifikata “Pllakatë” duhet të përmbajë tekstin si në vijim:

Bordi Teknik Nacional ndanë këtë:

PLLAKATË

(emri & mbiemri)

për

Angazhim dhe Bashkëpunim Afatgjatë si Kontribuues në Zhvillimin e KN CIGRE KO

Certifikata “Pllakatë për Nikoqir dhe/ose Sponsorë” duhet të përmbajë tekstin si në vijim:

Bordi Teknik Nacional ndanë këtë:

PLLAKATË

(emri & mbiemri/emri i kompanisë)

si

Shenjë e Mirënjohjes për Kontributin në Zhvillimin dhe Afirmimin e KN CIGRE KO

(Certifikatat nënshkruhet nga Kryesuesi dhe nga Sekretari i KN CIGRE KO).

Neni 6

Pllakata është me formë rrethore, me diametër 65mm(ose ndonjë formë tjetër me përmasa të njëjta) dhe e flakëruar në argjend. Njëra anë e pllakës duhet të ketë shenjën “KN CIGRE KO”, ndërsa në anën tjetër duhet të ketë të shtypur fjalët: “ Komiteti Nacional CIGRE Kosovë, Këshillit Ndërkombëtar për Rrjetet e Mëdha Elektrike – CIGRE”.

Pllakata duhet të vendoset në një kuti që i përgjigjet në mënyrë të përshtatshme, e cila nga jashtë duhet veshur me pëlhurë kurse në brendësi duhet të jetë e veshur me material të butë.


Kriteret Përcaktuese

Neni 7

“Mirënjohje për Përvojë Jetësorë”, (emri & mbiemri), u jepet individëve për:

- kontribut të gjatë dhe jashtëzakonisht me kualitet të lartë në KN CIGRE KO;
- kontribut të gjatë dhe të vazhdueshëm në organizimin dhe afirmimin e KN CIGRE KO;
- punë aktive profesionale në Komitetet Studiuuese në CIGRE-në vendore.



	<p>Këshilli Ndërkombëtar për Rrjetet e Mëdha Elektrike Komiteti Nacional CIGRE Kosovë</p> <p>RREGULLORE E MIRËNJOHJEVE</p>	<p>KN CIGRE KO</p>
	<p><i>ver. 1.0</i></p>	<p><i>page 3 / 5</i></p>

Neni 8

“Falënderim për Punë Aktive në Komitetin Studiues”, u jepet individëve për:

- për punimet e botuara në konferenca, simpoziume dhe takime të tjera si përfaqësues i KN CIGRE KO nga fusha e punës së Komitetit Studiues;
- për kontributin e jashtëzakonshëm në grupet punuese në Komitetet Studiuese të KN CIGRE KO;
- për pjesëmarrje aktive në punën e Komitetit Studiues.

Neni 9

“Mirënjohje për Punimin Më të Mirë” jepet në përputhje me kriteret e Nenit 34 të Rregullores së Punës të konferencave të KN CIGRE KO

Neni 10

“Pllakata” jepet si një mirënjohje e veçantë për këta individë:

- për punën e gjatë aktive dhe jashtëzakonisht të kualitetit të lartë në KN CIGRE KO përmes punimeve të rëndësishme, për numër të madh të punimeve të rëndësishme, aktiviteteve në kuadër të mbledhjeve të KN CIGRE KO, aktiviteteve të organizuara në kuadër të Komiteteve Studiuese dhe Grupeve Punuese etj.;
- për punën e vazhdueshme afatgjate, për organizimin dhe afirmimin e KN CIGRE KO si kryetar/anëtar i Bordit Teknik Nacional, kryesues i KS, ekspert, recensues, menaxher i grupeve punuese, organizator i takimeve në kuadër të KN CIGRE KO, etj.
- për punën aktive lidhur me përgatitjen e punimeve në mënyrë profesionale në kuadër të Komiteteve Studiuese të CIGRE-së, në përgjithësi.

Përveç kësaj, Pllakata u jepet edhe:


- Sponsorit të Përgjithshëm të KN CIGRE KO;
- Sponsorit të Artë të KN CIGRE KO;
- Sponsorit të Përgjithshëm të Konferencës së KN CIGRE KO;
- Sponsorit të Artë të Konferencës së KN CIGRE KO;
- Sponsorit të Konferencës së KN CIGRE KO.

Neni 11

Mirënjohjet “Mirënjohje për Përvojë Jetësore”, “Pllakat” dhe “Falënderim” i jepet të njëjtit person vetëm një herë.

Neni 12

Mirënjohjet “Falënderim për Punë Aktive në Komitete Studiuese” dhe “Mirënjohje për Punimin Më të Mirë” jepen në kuadër të mbledhjeve të Komiteteve Studiuese.

	<p>Këshilli Ndërkombëtar për Rrjetet e Mëdha Elektrike Komiteti Nacional CIGRE Kosovë</p> <p>RREGULLORE E MIRËNJOHJEVE</p>	<p>KN CIGRE KO</p>
<p>ver. 1.0</p>		<p>page 4 / 5</p>

Neni 13

Mirënjohjet “Mirënjohje për Përvojë Jetësore” dhe “Pllakatë” jepen në kuadër të ceremonisë së hapjes së Konferencës të KN CIGRE KO;

Neni 14

Mirënjohja “Mirënjohje për Përvojë Jetësore” jepet një herë në dy vjet, ndërsa numri i shpërblimeve të dhëna brenda një periudhë dyvjeçare nuk mund të jetë më i madh se 2.

Neni 15

Mirënjohja “Pllakatë” jepet një herë në dy vjet, ndërsa numri i shpërblimeve të dhëna brenda një periudhë dyvjeçare për punë profesionale nuk mund të jetë më i madhe se 3.

Neni 16

Mirënjohja “Falënderim” jepet një herë në dy vjet, ndërsa numri i shpërblimeve të dhëna brenda një periudhë dyvjeçare nga Komiteti Studiues nuk mund të jetë më i madh se 2.

Procedura mbi Dhënien e Mirënjohjeve

Neni 17

Propozimi për dhënien e mirënjohjes “Mirënjohje për Përvojë Jetësore” jepet nga kryesuesit e Komiteteve Studiuese për anëtarët e tyre.

Propozimi jepet me shkrim me arsyetimin përkatës te Bordi Teknik Nacional i KN CIGRE KO.


Neni 18

Propozimi për dhënien e mirënjohjes “Falënderim për Punën Aktive në Komitetin Studiues” jepet nga kryesuesi i Komitetit Studiues ose nga të paktën 5 anëtarë të KS. Propozimi duhet të jepet në formë të shkruar.

Propozimi miratohet ose refuzohet në njërin prej mbledhjeve të Komitetit Studiues me shumicën e votave përmes votimit të fshehtë.

Neni 19

Propozimi për dhënien e mirënjohjes “Mirënjohje për Punimin Më të Mirë” jepet në pajtim me nenin 33 të “Rregullores për Punën e Konferencave” të KN CIGRE KO.

	<p>Këshilli Ndërkombëtar për Rrjetet e Mëdha Elektrike Komiteti Nacional CIGRE Kosovë</p> <p>RREGULLORE E MIRËNJOHJEVE</p>	<p>KN CIGRE KO</p>
<p>ver. 1.0</p>		<p>page 5 / 5</p>

Neni 20

Propozimi për dhënien e mirënjohjes "Pllakatë" nga Bordi Teknik Nacional jepet nga Komitetet Studiuuese për anëtarët e saj.

Propozimi jepet me shkrim me arsyetimin përkatës te Bordit Teknik Nacional i KN CIGRE KO.

Neni 21

Bordi Teknik Nacional bën shqyrtimin e propozimeve të paraqitura dhe me shumicë të votave, përmes votimit të fshehtë, vendos se a i pranon apo refuzon propozimet.

Neni 22

Sekretari i KN CIGRE KO informon me shkrim propozuesin lidhur me Vendimin e Bordit Teknik Nacional.

Dispozitat Përfundimtare

Neni 23

Sekretari i KN CIGRE KO kujdeset për detyrat administrative në procedurën e ndarjes së mirënjohjeve.

Neni 24

Sekretari i KN CIGRE KO mbanë të dhënat e fituesve të çmimeve dhe i publikon ato në një publikim përkatës.

Neni 25

Ndryshimet dhe plotësimet e kësaj Rregullore kryhen sipas procedurës së njëjtë sikurse gjatë miratimit të saj.

Neni 26

Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit të saj nga Bordi Teknik Nacional (BTN) i KN CIGRE KO.



Kryetar i KN CIGRE KO
(Kryesues i BTN-së)

Mehmed Bula

Prof. Dr. Mehmed BULA

Datë: 26.03.2018, Prishtinë